

KOÇI PETRIT

SHTETIT

GJIROKASTER

POEZI

DIE SERIE  
UDHËHE

8SH-L  
P 55

8SH-L  
S'

KOÇI PETRITI

# PËRSËRI NË UDHË

Vjersha dhe Poema

100  
41893

BIBLIOTEKA E SHTETËS  
SHKODRA

SHTËPIA BOTONJESË «NAIM FRASHËRI»

## O KOHË E AKCIONEVE TË MËDHA

Erdhën aty nga çdo vis vullnetarë.  
Me fasha dielli e ylberi lidhur gushën  
Dhe zgjatën nga përfytyrim i tyre  
Dy krahë që ta përqafojnë fushën.

Janë të hekurtat krahë binarë,  
Mbështetur mbi shpatulla transhesh e betoni  
Që do të mbartin larg lokomotivat  
Siç mbart, rini ti sot revolucionin.

Nga vërvshëllima e ardhëshme e trenave  
Njerzit më të hekurt do ta hedhin hapin  
Më tepër do t'u trashet zverku demave  
Dhe arat më tepër drithra do të japin...

O kohë e akcioneve të mëdha!  
O ditë të hekurta, të ndriturat ditë!  
Ju dolët në skenë nga sinteza e viteve  
Siç dalin nga sinteza e popujve gjenitë.

## DIKUR

Dikur, në fëmini, kur s'dija mirë  
Pse shfrynte «shpend i hekurt» mbi katunde,  
M'i bëri nëna flokët të lëpirë,  
Siç bën me gjuhë delja shqerrën rudë.

Pastaj mes partizanëve më shpuri  
Me kokë, vështrimëmbël — ec — më tha,  
Si më lëshoi mbi gjunjët e një burri,  
Më shpoi: «Hë, puthe de, ësht' yt vëlla!»

Ai ish i plagosur. Kur më puthte,  
Kapell'e tij me yll ma prekte veshin.  
Un' e largoja kokën: kujtoja se mos digje  
Ndaj dhe dikush më talli e më përqeshi.

Një ditë tjetër prap' s'm'u nda nëna.  
Kish njerëz,  
Heshtnin ulur rrëth dikujt.  
Mbi syt' e tij sikur kish zbritur hëna  
— Hë, puthe tët vëlla — ajo m'u lut.

Në varr, mbi supe, shokë lufte e shpunë,  
U shkrehën pushkë,  
Tjetër gjë mënd s'mbaj.  
Së pari, atë ditë pashë unë  
Se kish të tjerë yj si yll i tim vëllai.

## DËSHIRA E KËSAJ TOKE

Mbi kodra, thellë perëndimit,  
Dremiste ndonjë re kokulur në horizont,  
Si kal'i lodhur prej luftimit,  
Që s'ndahet nga kufoma e të zot.

Lirishtat e mbetura djerrë,  
Të majmura nér shekuj nga gjethet dhe plehu,  
Nga malli të rritnin të lashta,  
Ushqyen në gji arra dheu<sup>1)</sup>...

U desh të vinin këto kazma,  
Këta fshatarë, ushtarë dhe studentë,  
Që të mos mbetej djerrë tok'e majme,  
Të mos shkarkoheshin kot retë.

Dhe ngjan sikur me vullnetarët  
Ndjen gaz edhe kjo re, që shi ka për të dhënë.  
Nga lumturia avuj tymos toka,  
Që nesër do të bëhet nënë...

---

1) Një lloj barishte, që lidh kokrra nën tokë, në vëndet djerrë.

## MALE, O MALE!

Male që fshihni kujtimet nën mjekra,  
Varg si koncil filozofësh seriozë,  
Mbledhur këtu që prej kohëve t'egra,  
Sonte përse po fjalosi?

Ju patë të ndeshej Pompei me Qezarë,  
Tundët kaq djepe t'ilireve nëna,  
Shkuan te ky udhëkryq kryqëtarë,  
Shkeli mbi ju gjysmëhëna...

Mbajtët të gjallë në këng' e jehona  
Zërin e Gjergj Kastriotit mbi shpinë,  
Lindët dhe burra në kohët e vona,  
Rritët Selam Salarinë.

Mblodhët, nën krisma patickash të reja,  
Çeta q'e ngritën lavdinë e një shpate,  
Vajzat i nisët si djem në beteja,  
Muzgjeve thatë çorape...

Netve, barinjtë mbi ju, krep më krep,  
Ngjan sikur ngjiten rrufe për të kapur;  
Krrabën në dor' e gazeten në xhep,  
Flasin për Letrën e Hapur...

Sot ju po shihni të tjerë banorë,  
Feksin prej kazmave varg, këto vise,  
Mpleksur nér marshe të rrept' e gazmorë,  
Rend gjenerata m'e re, m'optimiste...

Male që zgjohi nga mina e borie,  
Ku lindin bri kullash të hekurt qytete.  
Kaç lumturi studenteske, kaç diej  
Kur kini mbajtur mbi vete?...

## ÇAST VULLNETARËSH

Rreh anëdeti,  
Skuq perëndimi,  
Clodhen shkëmbinjt' e thërmuar nën kreshta,  
Rrjedhin ujvaret, si «Norma» e Belinit,  
Flenë studentët në rrjeshta...

Çëndra po shohin tani vullnetarët,  
Me duart plot kallo dhe plasa?  
Ndofta shpërthimin e minës së parë,  
Ndofta ullinj mbi taraca.

Ndofta ndonjërit i shkrepi dëshira  
Ta mbjellë dhe hënën me çadra,  
Ndofta heronjtë që njoihu në libra,  
Merr i rrjeshton në skuadra.

Vreshta të ardhëshme,  
Dallgë ullishtash  
Zbresin nga ëndrat mbi shtratin përdhes,

Mpleksur si mijra kordele dhe gishta  
Rreth kaçurela studentësh...

Jashtë, dezhurni me pushkë bën roje,  
Pushka të rëndë ja bën hapin, të rrëptë.  
Netve, kështu edhe gjyshërit tanë  
Ruanin bajlozët e detit...

Pushka në sup të studentit,  
Nervozja, e mënçura,  
Pushka gjithnjë fjalëpakët,  
Në mitrën e vet rrit dhe jetën dhe vdekjen.  
Si gruaja e fortë binjakët.

Rreh anëdeti,  
Nxin perëndimi,  
Çlodhen shkëmbinjt' e thërmuar nën kreshta,  
Rrjedhin ujvaret, si «Norma» e Belinit,  
Flenë studentët në rrjeshta.

## NË SE DO TË DUHEJ

Në se do duhej të binja ndonjë ditë,  
Të mbroja këto çadra vullnetarësh,  
Do doja që të mbetesha për jetë  
Si fëshfëritje e lumtur portokallësh,

Le të më mbartnin shokët përmbi supe,  
Në shtegun ku nga deti ndahen brigjet.  
Mbi mua heshtj' e dhëmshme le t'ulej,  
Aq kohë sa dhe perëndimi digjet

Kur muzgjeve student' e studentesha  
Të m'hidhnin lule, këngë dhe të shtëna,  
Ky bllok ullishtash t'ardhme, këto vreshta  
Do të m'i ndjenin fjalët e pathëna.

Si dor' e ngritur lart në lamtumirë,  
I vullnetarit shall mbi mua do digjej.  
Që vala të m'i prekte me mall flokët,  
Përjetësisht do gërryente këto brigje...

## LIRIKË FUSHE

Drurët dhe tërfili erë bien  
Dhe të ngjajnë thekrat sikur ecin.  
Shoku im, që sonte ka ditlindjen,  
Ndjeu mes fushe vitet ta thërresin.

Dhe të dalim grunjavet i shkrepi,  
Ku nga hap i bujkut shkurta hesht.  
Sa ditlindje sonte pi planeti?!  
Por veç një festohet, ja, kaq thjesht.

S'njeh si kjo ditlindje, ndofta, bota,  
S'vlejn' aty as pijet as orkestra:  
Mbrëmja derdh mbi ne të shtatë notat,  
Era korr lirika nëpër thekra.

## JANË RËNDUAR PEMËT DHE DRITHËRAT

Janë rënduar pemët edhe drithrat,  
Po piqet pjepri,  
Thahet thupr' e thanës,  
Del vjedhur nuselalës që nga hithrat,  
Përgjon fenerët e kombajnës.

Dua të më zerë sonte nata,  
Ku grunjat ecin varg si gra të rënda,  
Ku vajzat hedhin vrahun me lopata  
Dhe breshk' e ngathët fshihet nëpër shpëndra.

Në qerre do të hyp si një bir bujku,  
Që i pëlqen të bëhet traktorist,  
Që kur kalon ndonjë fshatark' e bukur,  
U shtie kot laraskave me plis.

Le të vrapijë tok me mua djali.  
Me flokë të pabindur, t'egër,  
Që ze rosak' e gerguj me kom kali  
Dhe fllosh u lidh zhuzhakëve të gjelbër.

Sonte në mes të fushës do të fle,  
Si një pojak që torbën var te pema,  
Teksa hyn lop' e huaj në kope  
Dhe bën që të pëllasin gjithë demat.

## TI DHE JOT BIJË

Unë shkoj me libra ndënë sjetull,  
Ti në prak rri ulur dhe tjerr lesh,  
Mirmëngjes, moj teto vetullvrejtur,  
Që në fshat veç mua më buzëqesh!

Teto, teto, shpesh ti ma ze rrugën,  
Pa më pyet vënd edhe pa vënd,  
Nëpër duar nis ta shpejtosh drugën,  
Sikur don të tjerrësh trillin tënd.

Pa më flet për çupën arësimtare,  
Ta ka qejfi dhëndër të më kesh,  
Po jot bijë kokën në dritare  
E ka nxjerrë e ëmbël na përqesh.

Pse, moj teto, del e ftoh sofatin?  
Çupa s'na përfillka fare ne:  
Nj'agronom ta nxjerrka fushës natën,  
Ti s'ja do, se paska tjetër fe.

Kot, moj teto, del e ma pret rrugën,  
Kot më pyet ti vend e pa vend,  
Çupa qesh, ti nis ta shpejtosh drugën,  
Sikur do t'i shesësh trillin tënd.

### SHPEJTOHJA

Shpejtosh qenë përfshirë që  
nëpër këtë vëllim që  
dëshironi që  
lloget e bëj.

Shpejtosh që  
dëshironi që  
lloget e bëj.

Shpejtosh që  
dëshironi që  
lloget e bëj.

Shpejtosh që  
dëshironi që  
lloget e bëj.


## NJË BASHKËNXËNSEJE

Tok me ne mësove ti kaq vjet  
Po sa keq, nuk erdhe dot pas nesh  
Ndaj në këngë t'ardhme të poetit  
Bashkënxeñëse e zgjedhur s'do të jesh.

Larg, n'akcione, kemi për të shkuar  
Ti u mbyllë brënda si molusk  
Pse, a s'lindëm tok për t'udhëtuar  
Si një zjarr i madh që rend në muzg?

Pash më pash atdheun do ta matim  
Drithra do të mbjellim dhe mbi shkëmb  
Kurse ti «natyra delikate»  
Mund të mburresh vec për nurin tënd.

Por ndër mënd për ne kur të të bjerë,  
Ditët bosh kur vetes t'ia çfletosh  
Si një gaz të madh që del nga dera  
Do të duash larg të na kërkosh.



Delikatin grusht mund ta përpjekësh  
Mund të bjesh përmbysh edhe të qash  
Që s'ke qen' e zonja të na ndjekësh  
Që s'ke pasur forc' as të na mbash.

Rend t'arrish në rrëthim e gëzuar.  
Thyeje, thyeje shpejt atë molusk  
Se ne lindëm tok për t'udhëtuar,  
Si një zjarr i madh që rend në muzg...

## PRANË TEJE DITËT S'DO T'I NGRYS

Tëmthat më rrahin,  
Zemra më digjet:  
Dua një shekull të rroj.  
Dhe larg n'u largofsha si ujrat nga brigjet  
Prap' ti më dhimbesh njësoj.

C'ardhtë mbi mua,  
C'rrjedhtë nën mua  
Qoftë e thjeshtë si ti.  
Unë gjith' njerëzit të dashur i dua,  
Ty, sa njëqind dashuri.

C'flasim kështu?  
C'heshtim kështu?  
Vallë në ç'ujra po zhytem?  
Ulur në çipin e syve të tu  
Dashke të pi dhe... të mbytem?

Jo, s'mund tē pi,  
Jo, s'mund tē hesht:  
Zemra pēr vepra mē digjet!  
Shekullin tim s'do ta ngrysja kaq thjesht  
N'ujrat ku lozin gjith brigjet...

## MALËSORI I «LEGJENDËS SË MISRIT»

Malësori i «Legjendës së misrit» dolli  
Një ditë që nga kënd i muzeumit  
Nga thesi i grisur kujtimet i çmbështolli  
Të merrte udhën e dashur të katundit.

I ra përmes një rruge dhe një sheshi,  
Që shpinte nga «pazari i vjetër.»  
Polici në trafik e pa dhe... buzëqeshi.  
Me t'ardhurin prej një epoke tjetër.

Mbërthyer nga reklamat dhe vitrinat,  
Ai qëndroi përballë një teatri,  
Në hyrje desh t'i zbathte opingat,  
Siç bënte në xhamin e fshatit.

Kur pa një bajraktar mustaqevarur  
Ta shtynin, duarlidhur, në skenë  
— Ma lini mua! thirri që nga salla,  
Ma lini që ta rjep të gjallë qenë!

Nga çfaqja shkoi me mëngë të përveshura  
Dhe an'e kënd kërkoj pazar' e vjetër  
Dhe e kuptoi nga fjalët «e pandeshura»,  
Që vinte prej njëepoke tjetër.

Atij, që prej legjendave kish dalë,  
Që emri i u ronit mbi rrrokjet «mi — sër»,  
Përkthenjës do t'i duhej sot për fjalët  
Revolucion, furrnaltë, komunizëm...

Mës vitesh është vënë që i dërgojtë  
dëshmorët i brendësise së përmes  
lirëzuarët i johurinë zviceranë i përdorët  
i lirëzuarët të veshur o mëdha vërtetë

lirëzuarët që kanë varet përmes vitesh  
dëshmorët i brendësise së përmes  
lirëzuarët që kanë varet përmes vitesh

lirëzuarët që kanë varet përmes vitesh  
dëshmorët i brendësise së përmes  
lirëzuarët që kanë varet përmes vitesh

lirëzuarët që kanë varet përmes vitesh  
dëshmorët i brendësise së përmes  
lirëzuarët që kanë varet përmes vitesh

## A R A E V E T M E

Në faqen e një kodre shkuan  
Xhandarë nga qyteti,  
Ca gërma të mëdha gërmuan  
Dhe shkruan: «Rroftë mbreti»!

Tek ar' e vetme erdh' fshatari  
Me qetë, elb të mbillte,  
T'ushqente shtatë zbatharakë  
Dhe gruan që për vit i pillte.

Si gur sinori bujku mbeti  
E s'dinte nga t'ja mbante;  
I ngjau sikur mbi «Rroftë mbreti»  
Një foshnj' e flakur qante.

I erdhi rrrotull me parmëndë,  
Siç vjen luan' i lidhur:  
Në zemër kish një gur të rëndë,  
Në fyt një lëmsh të hidhur.

Një çast iu duk se po ja sillte,  
Në një qeli të lagët,  
E shoqja (që çdo vit pillte),  
Të shtatë zbatharakët.

Po kur vështronte larg qelive  
Të errta dhe të ngushta,  
Vraponin gjith' bashkëfshatarët  
Shtrënguar dhëmb' e grushta.

Ndërsa me 'ta i bridhte mëndja  
Dhe fort i shponte qetë,  
E zëmëruar çau parmënda  
Mbi fjalët «Rroftë mbreti!»

## KORÇA

Ti zgjohesh nën një vetull kodrinore,  
Ku rrugë të kalldrëmta zenë fill.  
Shpesh herë ve kurorë prej dëbore,  
Shpesh herë hedh mbi sup një shall jeshil.

Morava kreshtëxhveshur dërgon erë,  
Në kopshte ku dremisin verës pleq,  
Gjer larg shfryn dërdëllitj' e buldozerit,  
Që shëmb Katavaroshin famëkeq.

Në park, Themistokliu, si breng' e largët,  
Nga mal' i Bigllës sytë i mban,  
Mos vallë sheh si zbret në Korçën plakë  
Gramenua leshragjatë me fustan?

Mos vallë ndjen të shuarat jehona?  
Mos vallë mallëngjehet për dikë?  
Po s'derdhin lot të hidhur nuset tonë  
Dhe as «Lëndink' e loteve» s'qan më...

Dhe «Luftëtar Kombëtar» te sheshi,  
Në perëndim vështrimin po e tret,  
Sikur përjetësishët përcjell në heshtje  
Çdo mbytje t'invadorëve në det...

Pëllumbat ja rrrethojn' dyfekn' e gjatë  
Ta pyesin për plagët dhe për trimat.  
Tek libraria, vajz' e kombinatit  
Blen librin tim dhe «Lulen e kujtimit».

Po un' e ndjej të vogël fare veteri,  
Që më të forta vjershat dot s'i thura,  
Kur shoh si zjen e merr qyteti jetë,  
Kur sjell ndër mënd kaq këngë dhe kaq burra.

## ÇAST PROVIMESH

Provim, provim...  
Alarm në trurin tonë,  
Përleshje datash, ngjarjesh, thëniesh t'urta  
(Napoleoni ish gati — thonë —  
Ta ndërronte një provim me shtatë luftra.)

Nga pirgje librash dalin dalngadalë,  
T'i shohim në provim të gjitha.  
Heroj, poetë e dijetarë,  
Duke fërkuar mjekrat porsi krifa.

Nga kohrat mblidhen gjith' «burrat e dheut»,  
Sikush nën sqetull mban një cop' atllas.  
Përpara u ve shpatën Skënderbeu,  
Kaluar mbi dorinë e ngritur kas.

Xhvarrosur nga qeli e ndonjë murgu,  
Vrapojnë rrrokjengrëna te porta  
Të rrallat fjalëplaka të Buzukut,  
Të marrin prap' të vetat pashaporta.

Bardi Homer, me lyrë e shkop nér duar,  
Si epos shkel mbi bango dhe katedra;  
Mes flakësh, Majakovski kokërruar  
Ngjit shkallët e poemave të veta.

Migjeni buzëqesh, kur rreth i rrinë  
Poetët-miq, q'urryen çdo lloj froni,  
Si një komet me bisht, nën pelerinë,  
Në shesh suljotësh çfaqet lord Bajroni...

Mbi mjegulla të ftohta filozofësh,  
Gjithnjë më sy të ndezur nga mendimi,  
Sintezë mënçurish, epokash  
Mes nesh ka hyrë Marksit dhe Lenini.

Të gjithë ulin kryet plot mendime  
T'i hedhin nga një firmë çdo librete.  
Po un' a mund t'ju ftoj në gjuhën time,  
Të shkojmë tok n'akcionet studenteske?

## LIRIKË

Ti larg bredh vetëm,  
Bryma brigjet zbardh...  
Por kot për mua shpesh të trembet gjiri,  
Unë ndjej  
          sikur nga gjith' ky mall i madh,  
Përbrënda më vjen rreth një gur mulliri.

Ne prap buz' ujtrash tok do të vrapijmë,  
Nga grusht' i njeri-tjetrit prap të pijmë,  
Pse trembesh ti?  
          Nga ndarjet a s'mësojmë,  
Ta çmojm' edhe më tepër dashurinë?

## KËNGË SULJOTE

Gjoli me gishtrinjt' e erës  
Leshrat-dallgë ngre.  
Dallg' e gjolit plot potere  
Rreh kalanë, rreh...

Brënda, lidhur këmb' e kokë  
Hesht «rebeli», hesht.  
— Hej, harbut — halldupi thotë,  
E, s'të shtyp si plesht?

Katër hapa larg prej robit  
Pret suljoti tjetër,  
Katër sy, si pend' e korbit,  
Nxijn' e shkrepin egër...

Katër vetulla të trasha  
Prekin dy qeleshe...  
— Vraje hasmin! — e shtyn pasha,  
Heshtje, prapë heshtje...

— Shkulja zemrën, ngulja shpatën,  
Hë... se s'pres më gjatë!  
Ky ta vodhi gruan natën,  
Ky ta vau têt atë...

... — S'dua! — pshoi suljoti prerë,  
Zgjidhe, frikë s'kam,  
Ja ta ther, ja të më therë,  
Veç në sheshmejdan.

Dor' e turkut ngriu mbi mjekër,  
Pamja krejt iu pre,  
Prap' kafshoi pa dashur egër  
Fillin e mustaqeve...

Gjoli me gishtrinjt' e erës  
Leshrat-dallgë ngre,  
Vrer' i gjolit plot potere  
Rreh kalanë, rreh...

## SHQETËSIMI IM

Sonte prap gjer vonë, zgjuar mbeta  
Jo si pelegrin qetsi të lus:  
Zemërdridhur fatet që talljeta  
S'do t'i shoh si murg që kokën krrus.

Por si shkulm që hedh mbi brigje detin  
Duke shtrirë gjëmën tej për tej  
Dua këtë çast ta shkund planetin:  
Çdo njeriu dremitjen ia ûrrej.

Endrra ime bredh e shkel kufijtë  
Qiellin vietnamez të shoh në zbardh  
Teksa kap në terr me intuite  
Si rënkon atje një shpirt i madh.

Mjaft u mbyt més flakësh foshnj' e gjorë!  
Mjaft liria shkoi në pushkatim!  
Ja pse s'mund të rri pa ngritur dorë  
Nga ky kënd i mëmëdheut tim.

## A F R I K A

Afrikë, o ritm i dhimbshëm Afrikë  
Ti po ta kishe zemrën delikate  
Nga vuajtjet si Arap i Venetikut  
Mund t'ishe thinjur krejt brënda një nate

Por prap buzqeshja jote di të flasë  
Më çiltër nga çdo virgjëresh' e bardhë  
Që var në qafë perla dhe elmazë  
Që ty t'i vodhi, o toka hallemadhe.

Po marrin plagë netët nga mëngjezet,  
Tymosin bijt' e tu në vrap mërinë  
Lëkur' e zezë u ndrit si kuajve qull në djersë  
Teksa tërheqin pas një copë diell: Lirinë

Afrikë, oaze ngjer gjak, Afrikë  
Më s'fshihen tigrat dot as nëpër xhungla  
Se në çdo lot e perlë e plumb' e këngë  
Ka hyrë dhe hakmarrjen end Lumumba...

## BALLADË LIQENI

Në mëngën e gjolit, ku çurkat\* shpesh vijnë,  
Marr grepin dhe pres fillikat,  
Kur hëna, si vajzë që fsheh me turp gjinë,  
Lëndinat me nur i spërkat.

Kli-kliu, kli-kliu me britma të brishta  
Këndesk' e kënetës këlthet,  
Kalimthi shkund shapka, shavar e shelgjishta,  
Un' ëndrat mes ujrave tret.

Sa bëj të hedh grepin mbi faqen e pastërt,  
Nën këmbët e mbledhura shuk,  
Si rruspë përralle me trup t'alabastërt,  
M'u çfaq një fytyr' e m'u zhduk.

Nuk bën të dremitësh mbi brigjet e jetës  
Më shkundi prej fundesh një zë.  
Kli-kliu këlthiti këndesk' e kënetës,  
Veç rruspa e bukur s'erdh më.

---

\* lloj rosash

mes drit hë rävet

## MES DRITHËRAVET

### P o e m ë

#### 1

Prap' mora valixhen me vete,  
Po nisem për udhë tani.  
Jam gati, kurdo, me një frymë  
Çdo rrugë n'atdhe ta përpj.

Pas shpine askush s'do të tallet:  
«Si ikën kështu 'mor i gjorë,  
«Ku dielli, i penguar nga malet,  
«Gjith' ditën s'të sheh as dy orë?»

Por ja, që për prehje s'jam prerë,  
Që ditët kaq bosh t'i rrufis  
(Të ndenjurat ujra mbajn' erë  
Mes hiesh, kur gjeth nuk lëviz.)

Pas shokve të mbetem nuk dua  
Dhe kurrë me kaq xheloz  
S'mi ndezi askush ndjenjat mua  
Sa zëri i atdheut tani...

2

Ky qënka një fshat pak i largët  
Me arat mes maleve t'egër  
Dhe toka aq shumë s'mban vlagë,  
Ndaj mbillet më tepër me thekër.

Tani për tani jam i huaj:  
Nuk di mes fshatarve të hyj,  
Cigare po ndez e po shuaj  
Dhe bishta mërzie pështyj.

Do doja ngurimin ta shkundja,  
Po ndofta s'jam krejt pa të meta.  
S'jam «krejt pa të meta», se fundja  
Dhe dielli ka njollat e veta.

Ndaj erdha këtu, midis jush,  
Jo t'uлем si pleqtë në shesh,  
Por kosha me pleh do të mbush  
Dhe krahët mbi brryl t'i përvesh.

Të lodhem dhe unë bri bujkut,  
Ku brazdave rend çafkëlori,  
Ku zbardh edhe feks, në të zhdukur  
Të diellit, mes arave, plori.

Të rrok si fshatar në të korra  
Një drapër me dorëz prej briri,  
Të kruhem kur ëmbël, nën sqetull,  
Më shpon një mustaqe kalliri.

Dhe si mund të mbetem i huaj,  
Ku era të lashtat lëviz?  
Kur nxijnë mullaret si buaj  
Dhe hëna çdo gjë kallais?

Ku kosa në jonxhën e gjelbër,  
Ja thotë një ritmi gazmor,  
Sikur të shkurtojë çdo emër  
Për këngë të thëna me zor.

3

«Këtu arançatë nuk pinë,  
Ndonjëri as emrin s'ja di,  
Po ti do të gjesht në çdo stinë  
Hoshaf e pekmez e raki.

Mbi shpella plot myshk, si prej llozhave  
Të veshura krejt në belluz,  
Ke qejf të dëgjosh në vend t'operave  
Si lopët pëllasin në muzg

Pas vattrash, në netët e ftohta  
Dëgjon historira, vëlla;  
Ngjan kënd i veçuar nga bota,  
Po rron me ndodhit' e mëdha.

Ne ishim dikur të pagdhendur,  
Por librat, ama, na i kish ënda.  
I ndanim fëmijët nga shkolla,  
Se dhitë na mbeteshin brënda...

...Armiku i klasës, sa ngryste  
Lëvrinte dinak e nervoz  
Që rendin e ri ta përbyste,  
Punonte gjithnjë nën rrogoz.

Pat' sherr dhe kur tokat për ndarje  
Litar' i këshillit i mati,  
Sa ligjin e ri një nga shokët  
Me gjakun e vet e spërkatit.

Por ti duhet mirë ta dish:  
Pa re s'mund të shkrepë rrufeja,  
Si lufta që s'bëhet pa trima,  
As paqja pa nuse të veja.

Dhe ja, s'na braktisi guximi  
Ta ngremë çdo fshat si qytetin...  
Se dihet që shpesh, nga fërkimi,  
Merr zjarr drur' i ri me të vjetrin.

I riu mund t'u thotë sot etërve:  
«Pa shihni! s'kullosin sot pata.  
«Po t'ishim dhe ne n'ato vite,  
S'do kishim një varg dekorata?»...

Kështu m'u rrëfye një mbrëmje  
I pari që njoha në fshat,  
Në fshatin, ku njerzit s'të lënkan  
Të mbetesh aspak fillikat.

#### 4.

Në jonxhë, pranë çezmave dhe vijave,  
Ka rënë për së dyti kosa.  
Rend shtërgu pas të bijve dhe të bijave  
Dhe bën të heshtin pellgjeve bretkosat.

Nga horizontet radiot fushës derdhin  
Muzik' e lajme, gjersa vjen mesnata.  
Nër kopshte ndonjë breshkë samarverdhë  
Nxjerr kokën dëgjon ritme dhe ballada.

Këtu pëllitj' e kaut është mpleksur  
Me gulçet e gërvimat e traktorit,  
Që dhëmbët ngul stërnishtave të djegura,  
Teksa mbarojnë korrësit së korruri.

Mes misrave, pas brazdave, në radhë,  
Sa zbardhëllen i bien vajzat shatës,

Pa ngjajnë, që nga larg, shamt' e bardha.  
Si delet në kangelet e De Radës...

...Në vatrën e kulturës ndizet vallja,  
Çunakët gdhijnë kuajt nér kullota  
Dhe mua më zgjerohet frymëmarrja,  
Kur pi të tilla net, që s'i njeh bota...

\* \* \*

E shoi traktorin fshatari,  
Fshatarkat shatat i lanë.  
Qetë përtypen në mes të nj'ugari,  
Sikur thash e theme po hanë.

Kusitë me qumësht u hoqën nga zjarret,  
Thur vajza gërsheetat e trasha.  
Nië film do të shohin në lëmë fshatarët,  
Mbi luftra në kohë të lashta...

5

Ti, fisi im,  
Lindur e ngrysur me dhi në kullotë,  
Thirre kur pe përtej malesh katunde:  
«Ua, dhe këtej paska botë!»

Miu, po të binte në magjet e tua,  
Kokën e thyente pas fundit.  
Zverdhnin si lulet e kungullit foshnjat,  
Mburrej i pari i katundit.

Mburrej pér dorza kamxhiku tē veshura n'ar,  
Hypur mbi mëzin e tredhur prej rrace.  
Erënda mendimit tē tij mesjetar  
Nxinte një qiejj injorance.

Deheshin burrat e lodhur,  
Mbeteshin grätë shtatzëna.  
Ti mbaje shtrirë pëllëmbën e ndotur,  
Fall tē tē shtinte fatthëna.

Mbrëmjes, si shkundje pas prakut opingat,  
Nuset i rrihje prej mllefit.  
Shpesh u besoje fallxhoreve shtriga,  
Si t'ishin Orakulli i Delfit...

... Ndonse u krruse nga skamja mbi brazda,  
Mbete i pastér, shpirtfoshnjë.  
Ti, nëpér festa pagane dhe dasma,  
Ngjyrat e shpirtit çpalosnje.

Ti, fisi im  
Plot reumatizém,  
Brejtur prej fyerjeve, hallevé,  
Vallé si munde kaq shum' optimizém  
Té mbjellësh mes këngve dhe valleve?

Hej, fisi im,  
Ufur nën muzgje, mbi shtretér prej balte,  
Sofrén e kishe tē varfér,  
Por ti jetëshkrimin te pasur e pate.

E kini vënë re fshatarin tonë,  
 Që prapa kokën e ka rrafsh,  
 Ndofta pse s'i vu nëna, që në djep,  
 Jastëk me pupla dhe mëndafsh?

E dini ju pse ka vështrim të thellë?  
 Pse dorën e ka plumb të rëndë?  
 Se tokën nëpër mjegull e ka mbjellë,  
 Me gjysm' opinge, pushkë dhe parmendë.

Dhe pse gjithnjë kasolle e kullë ai  
 I bënte me dritare aq të ngushta?  
 Mos donte që t'i kish dhe pér frëngji,  
 Të mbante nën shinjestër pyje e fusha?

Dhe ja, mbas kaq rrebesheve që ikën,  
 Shqiptar i zymt', i rrept' i koskëstrallët  
 Rrudh ballin ta kuptoj' agroteknikën,  
 Siç i kupton dhe kuajt nga dhëmballët.

I kanë plasur buzët makinistit,  
 U është xhvoshkur qafa qeve,  
 Vlaga ka dalë nga plasat e plisit,  
 Toka ndjen mall' e rrufeve.

Bujkeshave u janë pjekur llërët,  
U éshtë mpleksur byku něpér flokë,  
Mendim i tyre, èndér něpér èndér,  
Qënka shpérndarë ně çdo kokërr...

Qënka shpérndarë ně çdo kokërr gruri,  
Qënka shpérndarë ně çdo fije.  
I shoh ato edhe ně punë burri,  
Edhe t'i japid gji ndonjë fëmije.

Nuk dinë tē vënë hollë krem fytyre,  
Por dinë ato si bëhet buka,  
Si emrat e fëmijëve tē tyre,  
U zgjedhin lopve emrat më tē bukur.

Dhe èndërojnë qengja, pleh dhe shira  
Të rritet misri det parcelavet.  
Me gishtrinjt' e trashur dhe tē nxirë  
Ato qëndisin bukur, mbrëmjevet

...Makinëshirësja, nofullahekurt,  
Përtyp e gëlltit mijëra duaj.  
Unë tanë mes fshatarve kam hyrë,  
Vrahun po kthej... e ngas kuaj...

I kanë plasur buzët makinistit,  
Taliket ngrenë tym ně rrugë;  
Mbrëmjeve, lëmi shpérndan erë plisi,  
Erë benzine dhe bukë...

Grigjat kullotat e ngrëna  
 I lanë dhe zbritën më poshtë.  
 Mbi lëm' e mbi kroje shket hëna,  
 E verdhë si tas me kulloshtër.

Kush mund të mbetet pas mureve?  
 Kush mund të mbyllët në dhomë?  
 Ajri thith mushtin e drurëve,  
 Era tund biskun e njomë.

... Shtrihesh mes fushe, në lëmë,  
 Shtrihesh mes lëmit, në kashtë.  
 Delet bariu mbledh nën hënë,  
 Leshin e qethur bën bashkë.

Flokëspërkatur nga vesa,  
 Gazi të hyn gjer në palcë.  
 Ndodh që këmishën e kripur nga djersa  
 Vjen ta lëpin një dem rrace.

Digjet mbi flokët e mia  
 Ylli, si kok' e një llulle.  
 Sonte, siç ulet mbi ne poezia  
 M'e madhe në ç'vënd mund të ulej?

Dehur nga era e plisit, e plehut,  
 Shoh prapa togjesh me grurë, me elb,  
 Sofrën e madhe t'atdheut.

Shoh këta burra të bronxët, të shkathët,  
 Krrusur mbi cfurqe, krrusur mbi thasë,  
 Krrusur mbi vrahun e madh të përbashkët

Shoh dhe mendoj:  
 Brir' i alarmit të ndihej tanë,  
 Brir' i rrezikut të huaj,  
 Cfurqet do kthenin fshatarët e mi,  
 Hasmin ta ngrinin si duaj.

Ne më modernet armë do ngjeshnim,  
 Ne do t'i linim përgjysmë të korrat.  
 Ky mund të ishte alarmi m'i tmershëm,  
 Alarm' i panjohur nga kohrat.

Frap, do të brofnim nën tingujt e marshit,  
 Kurrë nën këngë të trishta,  
 Edhe me kosa e makina silazhi  
 Hasmin ta grimin, siç grijmë misrishta.

Larg do të mbarnim mbi shpinat e nxira  
 Mllefin e burrave,  
 Vrerin e grunjave,  
 Mbetur pas nesh të pashira.

Më mbërtheu tani në gji natyra,  
 Ku mendim i bukës bukë pjell.  
 Lodhj' e punës, mbirë mbi fytyra,  
 Me të lashta zemrën ma mbështjell.

Dhe s'u thinj kjo tokë nga kaq lindje,  
 Por bleron ajo nga këngët tonë;  
 Gjithénjë, e freskët dhe me bindje,  
 Rrit kallinj të rij e pemë të njoma

Se u dashka gjith' kjo pjellori,  
 Duhet bar' i butë si gëzof,  
 Duhet që të piqet ky kalli,  
 Pa dikush të bëhet filozof.

Plugu zbardh e brazda hap në hamull,  
 Unë rend mes bujqërvë të mbjell.  
 Tok' e bryllët, toka që nxjerr avull,  
 Me të lashta zemrën ma mbështjell.

*Gusht 1966.*

## MOTIVE STUDENTESKE

*Unë vij nga malet kreshtëmurmë...*

Unë vij nga malet kreshtëmurmë,  
Ku mbi shkëmb shqiponja sqepin mpreh.  
Ky qytet plot njerëz dhe plot zhurmë  
Ndjej sikur veç mua sot më sheh.

S'kam takuar kurrë rrjedhë jete  
Me kaq drita, parqe dhe ndërtesa.  
Një valixhe druri mbaj me vete,  
Plot me pemë, libra dhe ndërresa.

I kam hequr rrobat e shajakta  
Dhe opinga lope më nuk vesh,  
Por në s'di t'i hedh aq butë hapat,  
Ti djalosh i kreher mos më qesh.

Dhe në s'di ta lidh gravatën mirë,  
Ti zonjushe buzët kot i mbledh?  
Po un'ujë bjeshkëve kam pirë,  
Dhe në gjah s'ka dhëlpër që ma hedh.

Tok me ty në bango mund të ulem,  
Delikatja shoqe mos u tremb,  
Po të duash ti, të tregoj unë  
Se si mbin një lule përmbi shkëmb.

Unë vij prej maleve kreshtashpër,  
Nga një stan i vogël unë vij:  
Nëna ime tjerr tani pas vatrës,  
Ati fle nën pyllin me lajthi...

Për kohra, breza edhe gjurmë  
Dëgjoj kur pedagogu flet  
Kapitull' i një libri jam dhe unë  
Që hyj e dal në fakultet.

\* \* \*

### *Përmbi Dajt del hëna si një vetull...*

Përmbi Dajt del hëna si një vetull  
Dielli ra përtej, n'Adriatik  
«Milosaon» kam tani nën sqetull  
Dhe mes kodrës shkoj për në konvikt.

Çdo kontur konvikti po më duket  
Karavelë, nisur për zbulim,  
Pa më vjen ndër mend detar Kolombi  
Sikur hap një shteg në trurin tim.

...Mbi antenat, shtyllat dhe çatitë  
Nata zbret si shpend, po s'mund të ndalet,  
S'mund të ndalet dot ky shpend i hirtë  
Se e zbojnë larg hidroçentralet.

Muskuj dhe metal kërkojn' uzinat  
(Kafet ndjejnë mall pér anekdota),  
Një karvan i kuq autobuzësh  
Plogështinë e natës shtyp nën rrota.

Tituj filmash fleksin anës rrugës  
Një roman i bukur del në shitje  
Përkundrejt pallatit të kulturës  
Minareja hesht si pikçuditje.

Si një shkrep, ngarkuar me llampadha  
Ndrit mbi kodër Universiteti  
Rrotull tij, pas shtyllave të bardha  
Mbrëmja ndan lirikat e studentit...

\* \* \*

### *S'fle konvikti...*

s'fle konvikti,  
Shokët paskan ethe,  
Nën çdo sy vizor një rrëth mavë.

Ka provim,  
Motivet studenteske  
Kushedi ku bredhin në vetmi.

Mbi «Ç'të bëjmë» dhjetra koka krrusen,  
Stolin bosh në park e tall veriu.  
Kush s'i merr me mend berjoskat ruse,  
Nën të cilat shpesh krijoi Gjeniu<sup>1)</sup>?

Mbi të tjera libra zbardhin shpata,  
Një rrënqethje briri nga larg vjen:  
Roma dehet,  
Flagë nxjerr Ellada,  
Humbjet shfren Sulltani në harem.

Pa kur hyn gaztori i konviktit  
Salla zjen nga këngë dhe shaka,  
Veç ndonjë «peshkop», që s'lot nga vëndi,  
Konspekton «betejat e mëdha».

Hëna gondol...  
Shokët me shpirt qeshin,  
Gjer n'agim ndriçon pallati ynë.  
Çast provimesh!  
Nota, pas çdo rrjeshti,  
Si dinake e bukur na shkel synë.

---

1. Lenini

\* \* \*

### *Të të lidh me tokën nga kam ardhur...*

Si u ndodhëm ne kështu përballë,  
Si u lidhëm kaq papritur ne!  
Ti me ndrojtjen time qesh e tallesh,  
Unë duart s'di se ku t'i fsheh.

Hap pas hapi, pyjeve, nér nete  
E kam ndjekur ujkun plot guxim,  
Po si mund të ndodhka që kaq lehtë  
Të më mundësh ti me një vështrim

Dhe q'enigm' e ëmbël më mban lidhur,  
Që po gdhënd shpesh emrin tënd me brisk?  
E përtypa Nolin dhe Shekspirë,  
Veç me syt' e tu e paskam pisk..

\* \* \*

Vajz' e re mos pret dhe ti diçka  
Të të flas për arat edhe pyjet;  
Ç'sheh si ato lulet e mëdha  
Që nga vete dielli kthejnë kryet?

Do të bëhem çun që ndjek shkëndia,  
Do të bëhem plak shtëllungëzbardhur,  
Gjer t'i shtrij mbi ty rrënjet e mia,  
Të të lidh me tokën nga kam ardhur.

\* \* \*

*Porsi dy re që piqen rastësisht*

Porsi dy re që piqen n'udhëtim  
Dhe nga diçka i marrin njëra tjetrës  
U ndeshëm ne dhe ramë në mendim  
Të kapur fort pas flokëve të jetës.

Kështu të dy le t'ecim krah për krah  
Kujeta horizontet s'na i zhduk,  
Të ndjesh në shpirt motivet e mëdha  
Të të kem deg' e ti të më kesh trung.

Hiç mos u tremb në ndodhtë që nér net  
Të ta përzjej me vdekje dashurinë,  
Se mua që kur isha dhjetë vjet  
Një vdekje më rëndoi si gur mbi shpinë.

Ndaj do të vesh në çast kapot ushtari,  
Po më kërroi në zbor ndonjë trumpetë,  
Që nesër plumbi ty mos të të marri,  
Kur del nga port'e madhe e fakultetit.

Askush nën qiellin tonë s'do të presë  
Gjer ti të më humbasësh nëpër flagë  
Që mbi fustan' e bardhë të fejesës  
Shirit i zi mos qepet si një plagë.

\* \* \*

*Na zuri muzgu përmbi kodër...*

Na zuri muzgu përmbi kodër,  
Në një bot' ëndrash dhe përrallash.  
Mes shelgjesh dridhet gjol i vogël,  
Si sy i bukur mes qepallash.

Ne heshtim, heshtim. Pa kujtuar  
Një shpend na brofi pas një drize.  
E trëmbur t'i m'i hodhe duart,  
Pa ndënjam ngjitur... e s'lëvize.

Hutimi ynë aqë zgjati  
Sa zgjat një vetëtimë vere,  
Dhe ti, nga turpi dhe inati,  
Ja hodhe fajin asaj ferre.

*Eja të përshkojmë udhë, shpate*

Që i vogël, zbardhur krejt në brymë  
E kam gdhir' i vetëm ledh më ledh  
Dhe kur pyll i fjetur s'merrte frymë  
Kam dëgjuar bufin që të ngjeth.

Po s'u trëmба kurrë nga vetmia,  
Ndonsе pak nga bota merrja vesh,  
Ndaj tani, mbi shpatullat e mia,  
Ti si shqerk' e bardhë mund të flesh...

Mund të flesh,  
Por jo, ti s'mund të flesh,  
Kur bajamja çel si èndër vajze  
Dhe si peng të madh, që hyn mes nesh,  
Gonxhe po të lidh për gur unaze.

Kur mbi gjoks ti kryet ma mbështet,  
Mijra zilka — gjethesh troket plepi.  
Dhe natyra nxjerr nga xhepi i vet  
Hënën si pasqyrëz tualeti...

## II

Po vërsnikët tanë s'paskan fjetur,  
Zjarre partizane rrötull ndezin.  
Shqetësohesh ti mos kemi mbetur  
Ne të dy në bisht të këtij brezi.

Dhe mendon q'e ardhmja dhe të parët  
Shumë shpresa lidhën te ky brez,  
Grushtin mbledh, se shoqja moshatare  
Sonte vdes në frontin vietnamez,

Ndaj s'e ndjen kur vesa t'i njom flokët,  
Ndjen si koha ikën me galop,  
Do pa tjetër që dhe ne të ndrisim  
Si një llamb' e kuqe përmbi glob.

Do pa tjetër që dhe ne në radhë  
Të pëershkojmë baltra, udhë, shpate  
Mbi kurrise malesh mjekërbardhë  
Mbire gërxh më gërxh si zjarre nate.

### III

#### *Mes pëllëmbësh pushkën do ta marr*

Herët apo von'erdha në botë?  
S'je as von' as herët, na pret toka,  
S'më mjaftoka vetëm grusht i fortë  
Vetëm shpirt i butë s'më mjaftoka...

Ma ka shkruarjeta që tani  
T'i bëj ara buke këto kreshta  
Dhe si plis që s'ngopet dot me shi  
Unë s'ngopem dot me këto rrjeshta...

Ja kështu për udhë larg u nisa  
Si student, si bujk dhe si ushtar,  
Si një bisk që mbin e lidh dy plisa.  
Mes pëllëmbësh pushkë do ta marr.

\* \* \*

Po mall' i vëndit kë s'e mori?  
Kë mall' i madh s'e mundi?  
Tani po futem tek oborri,  
Kur fle i gjith' katundi.

Vec qen'i plakur e i lodhur  
Zgërdhiu të ngrënët dhëmbë,  
M'u hodh në fyt,  
Por kur më njohu  
Më ra si skllav ndër këmbë...

\* \* \*

*Që nga thelbi i Atdheut po vi...*

«Nënë, nesër më zgjo që me natë»<sup>1)</sup>  
Kur mbi kulme le çerdhen fajkoi.  
Do ta flak në një qoshe gravatën,  
Tok me shokët në mal do të shkoj.

Buk' e kazmë m'i var prapa portës  
Dhe të plakurin qen zgjidhur lere!  
Sot dhe flokët e prerë pas modës  
Më ka shkrepur t'i kreh si atherë.

---

1) Varg i Eseninit.

Zgjomë, zgjomë, harro dhëmshurinë,  
Ty pér gjumin mos t'ardhtë hiç keq.  
Do të dal përtej lumi me tinë,  
Ku kam zënë mëllënja me leq.

Eja, eja dhe ti n'aty udhë,  
M'afër diellit n'agim të të ngjit!  
Këngët tona fshijnë çdo rrudhë,  
Vrulli ynë dhe foshnjat i rrit.

Dhe mbështetu pas ëndrave tona,  
Që s'i ulëm nga lart mbi pëllëmbë,  
Por i ngrohim, si vezët shqiponja  
Mes shkëmbinjve, me punën e rëndë.

Mbylli sytë, ëndëro ti pér t'ardhmen,  
Flokbardhosheja ime, dhe qesh:  
Fëshfëritje të lashtash dhe pemësh  
Rreth katundit të xhveshur të ndjesh.

A s'të ngjan sikur buk' e lakrorë  
Po na sjell në lëmej, mbi taraca,  
Teksa rreth blegërijnë në kor  
Dhen pëlleja, leshbardha si palca?

Un' yt bir m'i fuqishëm, m'i mprehtë  
Që nga thelb i atdheut po vij!  
Ati im, ëndërronjës, i lumtur  
Le të prehet tani nën lajthi.

... Nënë, zgjomë ti nesër menatë,  
Kur mbi kulme lë çerdhen fajkoi!  
Do ta flak në një qoshe gravatën,  
Do të qepem mbi shkëmb dhe me thonj.

## PËRMBAJTJA

Faqe

O kohë e akcioneve të mëdha .....	3
Dikur .....	4
Dëshira e kësaj toke .....	6
Male, o male! .....	7
Çast vullnetarësh .....	9
Në se do të duhej .....	11
Lirikë fushe .....	12
Janë rënduar pemët dhe drithërat .....	13
Ti dhe jot bijë .....	15
Një bashkënxonje .....	17
Pranë teje ditët s'do t'i ngrys .....	19
Malësori i «legjendës së misrit» .....	21
Ara e vetme .....	23
Korça .....	25
Çast provimesh .....	27
Lirikë .....	29
Këngë suljote .....	30
Shqetësimi im .....	32
Afrika .....	33
Balladë lijeni .....	34
Mes drithëravet (poemë) .....	35
Motive studenteske .....	47

41993

BIBLIOTEKA E SHTETIT  
GJURKASHEF

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967